



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:012497

Datë: 27.02.2023

Numri i dokumentit: 04021037

CML.nr.1/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Muhamet Rexha, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Rrustem Thaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr. M. nga fshati ..., Komuna e M., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Albert Kryeziu nga M., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) sh.a, - P., -Distrikti në Gj., të cilin me autorizim e përfaqëson A. K., me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.932/2021 të datës 29.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 21.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet, si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr.932/2021, i datës 29.08.2022, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, C.nr.42/2020, i datës 02.12.2020, ashtu që vendoset të: REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. M., nga fshati ..., Komuna e M., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) sh.a, - P. -Distrikti në Gj., që paditësit Rr. M. nga fshati ..., Komuna e M., në emër të një page përcjellëse t'ia paguaj shumën prej 490.00 €, dhe në emër të tri pagave jubilarë t'ia paguaj shumën prej 1,470.00 €, në shumën e përgjithshme prej 1,960.00 €, me kamatë ligjore nga data e e paraqitjes së padisë e deri në realizimin e pagës përcjellëse dhe pagave jubilarë.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, C.nr.42/2020, të datës 02.12.2020, është vendosur që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. M. nga fshati ..., Komuna e M. Detyrohet e paditura KEDS-Distrikti në Gj., që paditësit Rr. M. nga fshati ..., Komuna e M., në emër të një page përcjellëse t'ia paguaj shumën prej 490.00 €, dhe në emër të tri pagave jubilarë t'ia paguaj shumën prej 1,470.00 €, në shumën e përgjithshme prej 1,960.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi më datë 01.12.2020, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 115.00 euro, në emër të taksës shumën prej 31.00 euro dhe në emër të përfaqësimit për dy seanca nga 135 euro, në shumën prej 270.00 euro, gjithsejt shumën prej 416.00 euro.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.932/2021 të datës 29.08.2022, është refuzuar e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) sh.a, - P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë, C.nr.42/20, i datës 02.12.2020, është vërtetuar.

Kundër këtij aktgjykimi Prokurori i Shtetit me kohë ka paraqit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale nga neni 247 paragrafi 1 pika b), të Procedurës Kontestimore (LPK), me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, të prishen aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë dhe qështja të kthehet në rivendosje.

Në kuptim të dispozitës së nenit 250 të LPK-së, gjykata ka caktuar seancën dëgjimore për të cilën janë njoftuar Prokurori i Shtetit dhe palët në procedurë, prezent ishin i autorizuari i paditësit, ndërsa ka munguar prokurori i shtetit, dhe e paditura, të cilët kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregulltë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 251 të LPK-së, shqyrtoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe gjeti se:

Kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Prokurori i Shtetit më datë 11.11.2022 ka paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me të cilën ka theksuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e lidhur dhe e nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës

dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, ndërsa bazuar në dispozitën e nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 parashihet që: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet", që nënkupton se kjo marrëveshje ka qenë në fuqi deri më datën 31.12.2017. Nga kartela e punëtorit me numër ..., është vërtetuar fakti se paditësi, ka gjithsej 42 vite e 6 muaj përvojë pune, për të cilat jashtë KEDS ka 36 vite, ndërsa në KEDS i ka 6 vite e 5 muaj përvojë pune si teknik i rrjetit në Departamentin e Sistemit të Operimit të KEDS-it. Ndërsa sipas vendimit të KEDS me numër ..., të datës 04.11.2019, i është ndërprerë kontrata e punës në KEDS, sipas fuqisë ligjore me rastin e mbushjes së 65 viteve moshë. Paditësi, vitin jubilar prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2007, në këtë kohë nuk ka ekzistuar marrëveshje, pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, dhe ka qenë në fuqi deri më datë 31.12.2017, atëherë rezulton se kjo marrëveshje nuk ka qenë në fuqi dhe se kjo marrëveshje nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive me të cilën ishin përcaktuar shpërblimi jubilar dhe pagat përcjellëse. Prandaj gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vepruar kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për pagë jubilarë, pasi që viti jubilar i 30-të ka qenë vitit 2007, që i bie para se të hyjë në fuqi Marrëveshja Kolektive dhe e drejta në pagë jubilarë nuk i ka takuar dhe se vendimi i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me pagat për përcjellje në pension nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse paditësi kur ka dal në pension më datë 20.11.2019, prapë Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk ka qenë në fuqi, dhe në këtë drejtim kompensimi për paga për përcjellje në pension dhe për tri paga jubilarë rrjedhimisht nuk i ka takuar, meqenëse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk ka qenë në fuqi e njëjta nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe paditësit i ka munguar baza ligjore për realizimin e kërkesës me padi. Ndërsa pretendimi i Gjykatës së Apelit, se paditësi bazën ligjore e ka krijuar me vendimin e brendshëm të KEK-ut, ne kemi vlerësuar se Gjykata e Apelit gabimisht i është referuar vendimit të KEK-ut nr..., të datës 10.04.2019, dhe vendimit tjetër me numër ..., i datës 23.08.2019, sepse sipas vlerësimit të zyrës tonë me këtë vendim ju njihet e drejta në kompensim të pagave jubilarë punëtorëve të KEK-ut, për periudhën kohore prej 01.01.2015 deri në vitin 2019. Ndërsa paditësi, në këtë periudhë deri në ditën ku ka dal në pension sipas kontratës ka punuar në KEDS, çka do të thotë se KEDS asnjëherë nuk ka nxjerr ndonjë vendim që ju njeh të drejtat për shpërblim jubilar punëtorëve të vet. Pra Kompania KEDS, operon si kompani e veçantë dhe në këtë rast kemi të bëjmë me dy subjekte të ndryshme e rrjedhimisht punëdhënës të ndryshëm, që operojnë si subjekte të veçanta juridike.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shteti, mbështetet në pretendime të natyrës së tillë për të cilat kërkesa për mbrojtje

të ligjshmërisë është e bazuar dhe e mbështetur në prova në shkresat e lëndës dhe në dispozita ligjore.

Me dispozitën e nenit 247 paragrafi 1, përcaktohet se: “ *Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë: a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po që se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po që se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale*”, në këtë çështje juridike kontestimore kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u referohet shkaqeve për të cilat Prokurori i Shtetit ka të drejtë që përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të kundërshtoj vendimet e formës së prerë të gjykatës, konkretisht për nenin 247 paragrafi 1, pika b, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, andaj një kërkesë e tillë është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në një gjendje të tillë të çështjes, përfundimet dhe vendosjen e gjykatave të instancës më të ulët, nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, të dy gjykatat e lartë përmendura gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar. Gjykata nuk e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, dhe të gjykatës së shkallës së dytë, për shkak se me aktgjykimet e atakuara gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe nuk ka pasur shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore, mirëpo nga ana e gjykatës të shkallës së parë gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit, e po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale kur e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i përket kompensimit të pagave përcjellëse dhe jubilarë, si të drejtë dhe të ligjshëm. Në rastin konkret papia e paditësit është e pa bazuar sepse paditësi, vitin jubilar prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2007, në këtë kohë nuk ka ekzistuar marrëveshje, pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe ka qenë në fuqi deri më datë 31.12.2017, nga kjo rezulton se kjo marrëveshje nuk ka qenë në fuqi dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive me të cilën është përcaktuar shpërblimi jubilar dhe pagat përcjellëse. Prandaj gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vepruar kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për pagë jubilarë, pasi që viti jubilar i 30-të, ka qenë vitin 2007, që i bie para se të hyjë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, dhe e drejta në pagë jubilarë nuk i ka takuar.

Gjithashtu vendimi i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me një pagë për përcjellje në pension nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse paditësi në pension ka dal më datë 20.11.2019, gjë që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk ka qenë në fuqi, sepse e njëjta ka qenë në fuqi deri më datë 31.12.2017, dhe në këtë drejtim kompensimi për paga për përcjellje në pension rrjedhimisht nuk i ka takuar, meqenëse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk ka qenë në fuqi e njëjta nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe paditësit i ka munguar baza ligjore për realizimin e kërkesës me padi.

Nuk qëndron as konstatimi i Gjykatës së Apelit, se paditësi bazën ligjore e ka krijuar me vendimin e brendshëm të KEK-ut, kjo për faktin se Gjykata e Apelit gabimisht i është referuar vendimit të KEK-ut nr..., të datës 10.04.2019, dhe vendimit me numër ..., të datës 23.08.2019, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me këtë vendim ju njihet e drejta në kompensim të pagave jubilarë punëtorëve të KEK-ut, për periudhën kohore prej 01.01.2015 deri në vitin 2019, dhe jo edhe punëtorëve të KEDS-it. Paditësi, gjatë kësaj periudhe deri në ditën ku ka dal në pension sipas kontratës ka punuar në KEDS, çka do të thotë se KEDS-i, asnjëherë nuk ka nxjerr ndonjë vendim që ju njeh të drejtat për shpërbllim jubilar punëtorëve të vet. Pra Kompania KEDS, operon si kompani e veçantë dhe në këtë rast kemi të bëjmë me dy subjekte të ndryshme e rrjedhimisht punëdhënës të ndryshëm, që operojnë si subjekte të veçanta juridike, andaj vendimi i KEK-ut, nuk mund të merret si bazë edhe për punëtorët e KEDS-it.

Andaj nga të cekurat më lartë, nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike - kontestimore, padia e paditësit është pa bazë ligjore, dhe si e tillë nuk mund të aprovohet si e bazuar, prandaj vendosi ta refuzoj në tërësi duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës, për faktin se e paditura nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Sipas arsyeve të sipër theksuara me lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 245, dhe nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
CML.nr. 1/2023, më datë 21.02.2023

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Muhamet Rexha